



Pranuar / Dorezuar Prinjenal/Prodato Received/Delivered	08.06.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMSHU	2958	2021	113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.396/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.396/2021, të datës 07.05.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr.„Bajram Kelmendi“, Nr. 227, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 07.06.2021, mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr. 396/2021 e datës 07.05.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja tani e pensionuar, me datë 07.05.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2271/2021, të regjistruar me A.nr.396/2021, në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me kërkesën e datës 23.03.2021 për pagesën e tri pagave përcjellëse jubilarë me rastin e pensionimit, siç parashihet me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.05.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa me datë 02.06.2021, Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qellim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, për vendosje në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.



396/2021 e datës 07.05.2021 të parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 2271/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 04.03.2021, të U,D Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankesën e datës 06.05.2021, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 19.02.2016; Lista e pagave për periudhën 1 deri 31 mars 2021. Kërkesën e datës 23.03.2021 të ankueses drejtuar Zyrës Ligjore të MPMS, , Akt Emërimin i datës 19.02.2016, Vendimi i datës 09.03.2021; Lista e pagës e datës 01.03.2021, deri me datë 31.03.2021, për ankuesen; Përgjigje në ankesë e datës 02.06.2021, me numër protokolli 2796/20214, Pagesa nga faqe 9 deri 13.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjithave shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse,*

Bazuar në shkresat e lëndë, Kolegji ka gjetur se ankuesja ka qenë e punësuar në pozitën e Zyrtare për Përgatitjen dhe Realizimin e Pagesave, në Divizionin e Pensioneve, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Me Vendimin me numër protokolli nr. 44 të datës 04.03.2021 të U. D Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së, ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 09.03.2021, duke i njohur njëkohësisht të njëjtës edhe të drejtën e realizimit të një page në vlerën e pagës së fundit mujore. Ankuesja më datë 23.03.2021 ka parashtruar kërkesë me shkrim pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale/Zyra Ligjore, që ti njihet e drejta ligjore e kompensimit të tri pagave përcjellës dhe tri pagave jubilarë me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Pas heshtjes së organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 23.03.2021 të ankueses, e njëjta brenda afatit ligjore për heshtje administrative sipas nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, me pretendimin ankimor që bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, ti njihet e drejta e tri pagesave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë për 45 përvojë pune. Me tej kërkon që Këshilli lëndën ta kthej për trajtim të mëtejme të organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe së e njëjta ashtu siç është përcaktuar me nenin 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë në fuqi vetëm tri vite, respektivisht deri me datë 31.12.2017, dhe e njëjta nuk është ripërtëri nga palat nënshkruese. Andaj, duke u nisur nga fakti së Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk është me e zbatueshme, Kolegji konstaton se pretendimi i ankueses për njohje të së drejtës për kompensimin e tri pagave përcjellës me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë është i pa bazuar.

Bazuar në nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenin 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se u. d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe



Mirëqenies me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll nr. 44 të datës 04.03.2021, me të cilin ankueses i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, respektivisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda Nr. A. nr. 396/2021**

**Rushit KAJTAZI**  
\_\_\_\_\_  
Procesmbajtës

**Ardita HAXHNIKAJ - DEMI**  
\_\_\_\_\_  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së

